# DËSHMI ARKIVI

**A-455594**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Top Poll: Zhgënjim i madh i shqiptarëve nga Gjykata e Hagës |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/top-poll-zhgenjim-i-madh-i-shqiptareve-nga-gjykata-e-hages-i586916` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 14:56:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 14:52:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5f5d9f00af96935f93a64be13a33414ac7be677fb5424be5ab1a4e200a56cccc` |
| TEKSTI | `26e085fd0da7bf5fed02300e15b3c28d04bfb840432b80178bac54210a079e07` |
| PAMJA | `ad878d0d79918dffad8f76ee7f4cc88fbe3d95f7c52d569d99d5df51c7f50c16` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e0d6ef1058c80c7525cc74f6bede5754596297a8ffcea1e8c5ee30adccef090c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e0d6ef1058c80c7525cc74f6bede5754596297a8ffcea1e8c5ee30adccef090c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Top Poll: Zhgënjim i madh i shqiptarëve nga Gjykata e Hagës

TemA
18 Shtator 2026, 16:52Rajoni TEMA

**Nga Eduard Zaloshnja**

Dje zhvillova sondazhin **elektronik** Top Poll për emisionin Top Story, përmes shpërndarjes së linkut të pyetësorit me SMS krejt të rastësishme nga Vermoshi në Konispol. Pyetësorin e plotësuan 1223 banorë të rritur të vendit. Tema e sondazhit ishte vendimi i Gjykatës së Hagës për katër udhëheqësit e UÇK-së.

Pyetjes kryesore "Nga sa e keni ndjekur gjykimin e 4 udhëheqësve të UÇK-së në Hagë, a mendoni se ata janë fajtorë për krime lufte?" plot 80.5% e të anketuarve iu përgjigjën "Anoj nga jo". Pra shumica dërrmuese e banorëve të rritur të Shqipërisë nuk janë dakord me vendimin e GJykatës së Hagës, që u ngrit për të përfaqësuar popullin e Kosovës (nën trysninë ndërkombëtare).

Rreth 14.3% e të anketuarve ishin dakord me vendimin e Gjykatës së Hagës dhe 5.2% ishin të dyzuar, por ata ishin kryesisht të rinj (ndoshta me njohuri të mangëta rreth të luftës së UÇK-së…).

**Grafiku 1**




Pyetjes "Si ju duket reagimi i politikës në Shqipëri ndaj dënimit të 4 udhëheqësve të UÇK-së në Hagë? rreth 56.3% e të anketuarve u përgjigjën "I duhuri". Ndër ta mbizotëronin të anketuar që kishin votuar vjet për PS-në. Nga ana tjetër, rreth 32.2% u përgjigjën "I vakët", dhe shumica dërrmuese e tyre ose nuk kishin

votuar fare ose kishin votuar për partitë opozitare. Nërkohë 11.5% u përgjigjën "I ashpër", ku shumica ishin të rinj...

**Grafiku 2**




Pyetjes "Me kë mendoni se ka qenë komuniteti ndërkombëtar më i ashpër deri më sot në lidhje me krimet e luftës të kryera në Kosovë?" pothuaj 89% iu përgjigjën "Me shqiptarët" duke shprehur kështu zhgënjimin pothuaj unanim të popullsisë së rritur të Shqipërisë me qendrimin që ka mbajtur komunteti ndërkombëtar ndaj krimeve të luftës në Kosovë. Në një vend ku pothuaj 90% e popullsisë i konsideron SHBA-në dhe BE-në si partnerët më të rëndësishëm strategjikë, zhgënjimi i shprehur në këtë sondazh flet shumë...

**Grafiku 3**



Von der Leyen anashkalon Serbinë dhe Bosnjën në turneun e saj në Ballkan

15:10 Rajoni / 1 koment

Avokati i Thaçit reagon ndaj deklaratës së Marta Kos: Nuk të takon ta paragjykosh çështjen ndaj tij

15:00 Rajoni / 2 komente

Protestë në Prishtinë, pro UÇK-së - Djali i Jakup Krasniqit: Të bashkohemi përtej partive e ndasive! Historinë e

Çlirimtarëve nuk mund ta fshijë askush

13:30 Rajoni / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.